

**2012, kroçerat fillojnë “prenotimet” për lundrime drejt Durrësit
26 Tetor 2011**



Ende pa u mbyllur sezoni turistik i këtij viti në Durrës, kompanitë e lundrimit të kroçerave kanë nisur prenotimet për vitin e ardhshëm. Ndërkaq sot paradite në kalatën 4 të portit detar është ankoruar kroçera “Kristina Katerina” me 323 turistë nga Finlanda.

Burime nga agjencia detare “Drianbra” bënë të ditur se sipas marrëveshjes me Autoritetin Portual, kroçera “Kristina Katerina” në fillim të sezonit të ardhshëm veror do të mbërrijë në Durrës dy herë brenda tre javësh.

“Kristina Katerina” do të jetë në Durrës më 16 prill dhe 3 maj 2012, me rreth 670 turistë në bord, ndërsa gjatë këtij viti ajo me 1632 udhëtarë gjithsej ka lundruar 4 herë të tjera drejt qytetit bregdetar.

Kroçera “Kristina Katerina” po zhvillon aktualisht një tur mesdhetar 1-javor që ka nisur në Dubrovnikut (Kroaci), Barit (Itali) ndërsa sot në mbrëmje pas vizitës në Durrës do të vijojë lundrimin për në portin e Kretës dhe në Santorini (Greqi).

Nga burimet e Autoritetit portual, mësohet se nesër në kalatën 4 do të ankorohet trageti “Athena”, ndërsa më 8 nëntor është programuar mbërritja e kroçerës “Artania” me një gjatësi 230 metra dhe me kapacitet prej 1200 udhëtarësh turistë.

Gjatë këtij sezoni veror në portin më të madh të vendit janë ankoruar kroçerat dhe superjahtet “Arion”, “Kristina Katerina”, “Island Sky”, “Clipper Odissey”, “Panorama”, “Pegasus” dhe “Ocean majesty”-thanë burimet portuale. Në kalatat e portit janë ankoruar gjithashtu dhjetra jahte dhe barka me vela, të cilat kryejnë lundrime në porte të ndryshme të Adriatikut dhe Jonit.

